



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 shtator 2021
Nr. ref.: VMSP 1857/21

AKTVENDIM PËR MOSPËRMBARIM

lidhur me

AKTGJYKIMIN

e

Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës

të 19 majit 2016

në

rastin nr. KI132/15

parashtrues

Manastiri i Deçanit

Vlerësim i kushtetutshmërisë së dy Vendimeve të 12 qershorit 2015, nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Objekti i çështjes:

1. Bazuar në nenin 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 19 (Marrja e vendimeve) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 66 (Zbatimi i vendimeve) të Rregullores së punës nr. 01/2018 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës), objekti i çështjes është: (i) vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), përkitazi me zbatimin e Aktgjykimit në rastin KI132/15, me parashtrues *Manastiri i Deçanit*, Aktgjykim i 19 majit 2016 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI132/15), nga ana e autoriteteve përgjegjëse të Republikës së Kosovës; dhe (ii) vendimmarrja e Gjykatës përkitazi me Aktvendimin për Mospërmbarrim dhe Njoftimi përkatës për Prokurorin e Shtetit, siç është përcaktuar në paragrafët (6) dhe (7) të Rregullit 66 të Rregullores së punës.

Baza juridike për nxjerrjen e Aktvendimit për Mospërmbarrim dhe Njoftimin e Prokurorit të Shtetit:

2. Gjykata fillimisht do të citojë, e më pas elaborojë, bazën juridike për nxjerrjen e këtij Aktvendimi për Mospërmbarrim dhe lëshimin e Njoftimit për Prokurorin e Shtetit përkitazi me Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI132/15. Në vijim, dispozitat relevante të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së punës:

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 116
[Efekti Juridik i Vendimeve]

1. *Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.*
[...]

Ligji për Gjykatën Kushtetuese

Neni 19
(Marrja e Vendimeve)

1. *Gjykata Kushtetuese vendos si trup gjykues i përbërë prej të gjithë gjyqtarëve të pranishëm të Gjykatës Kushtetuese.*
2. *Gjykata Kushtetuese ka kuorum nëse janë të pranishëm shtatë (7) gjyqtarë.*
3. *Gjykata Kushtetuese merr vendime me shumicën e votave të gjyqtarëve që janë të pranishëm dhe që votojnë.*
[...]

Rregullorja e punës

Rregulli 66 (Zbatimi i vendimeve)

- (1) Vendimet e Gjykatës janë të obligueshme për gjyqësorin dhe për të gjithë personat dhe për institucionet e Republikës së Kosovës.*
 - (2) Të gjitha organet kushtetuese, si dhe gjykatat e autoritetet, janë të obliguara të respektojnë, të jenë në përputhje dhe të zbatojnë vendimet e Gjykatës, brenda kompetencave të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.*
 - (3) Të gjithë personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar të respektojnë vendimet e Gjykatës dhe t'u përmbahen atyre.*
 - (4) Gjykata mund të specifikojë, në vendimin e saj, mënyrën dhe afatin kohor për zbatimin e vendimit të Gjykatës.*
 - (5) Organi i obliguar për të zbatuar vendimin e Gjykatës do të dorëzojë informatat, nëse kërkohet dhe ashtu siç kërkohet me vendim, për masat e ndërmarra për zbatimin e vendimit të Gjykatës.*
 - (6) Në rast të moszbatimit të një vendimi, ose të vonesës në dhënien e informacioneve për Gjykatën për masat e ndërmarra, Gjykata mund të lëshojë një aktvendim në të cilin do të theksohet që vendimi nuk është zbatuar. Ky aktvendim publikohet në Gazetën Zyrtare.*
 - (7) Prokurori i Shtetit informohet për të gjitha vendimet e Gjykatës që nuk janë zbatuar.*
 - (8) Sekretariati, nën mbikëqyrjen e gjyqtarit, i cili në pajtim me rregullin 58 e ka hartuar vendimin, do ta përcjellë zbatimin e vendimit, si dhe, sipas nevojës, do t'i raportojë Gjykatës me rekomandimin për procedurat e mëtejme ligjore që duhet të ndërmerren.*
3. Baza e lartcekur ligjore paraqet rregullimin kushtetues dhe ligjor bazuar mbi të cilin Gjykata është e autorizuar të ndërmarrë veprime përkitazi me monitorimin e zbatimit të Aktgjykimeve të saj dhe masat përkatëse në rast të konstatimit të moszbatimit të tyre.
 4. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, vendimet e saj janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Për më tepër, bazuar në të njëjtin në lidhje me rregullin 66 të Rregullores së punës: (i) të gjitha organet kushtetuese, si dhe gjykatat e autoritetet, janë të obliguara të respektojnë, të jenë në përputhje dhe të zbatojnë vendimet e Gjykatës, brenda kompetencave të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj; dhe (ii) të gjithë personat fizikë dhe juridikë janë të obliguar të respektojnë vendimet e Gjykatës dhe t'u përmbahen atyre.
 5. Gjykata gjithashtu thekson se bazuar në rregullin 66 të Rregullores së punës, Gjykata mund të specifikojë në vendimin e saj: (i) mënyrën dhe afatin kohor për zbatimin e vendimit të Gjykatës; (ii) organet e obliguara për të zbatuar vendimin e Gjykatës dhe të dorëzojnë informatat, nëse kërkohet dhe ashtu siç kërkohet me vendim, për masat e ndërmarra për zbatimin e vendimit të Gjykatës; (iii) në rast të moszbatimit të një vendimi, ose të vonesës në dhënien e informacioneve për Gjykatën për masat e ndërmarra, Gjykata mund të lëshojë një Aktvendim në të cilin do të theksohet që vendimi nuk është zbatuar dhe të publikojë këtë qëndrim

në Gazetën Zyrtare; dhe (iv) të informojë Prokurorin e Shtetit për të gjitha vendimet e Gjykatës që nuk janë zbatuar.

6. Bazuar në paragrafin (8) të Rregullit 66 të Rregullores së punës, Gjykata përmes mekanizmave të saj përcjellë zbatimin e vendimeve dhe mund të ndërmarrë procedura të mëtejme ligjore. Vlerësimi i zbatimit të vendimeve të Gjykatës bëhet në mënyrë periodike dhe në rast të konstatimit se një vendim nuk është zbatuar, Gjykata nxjerr Aktvendim për Mospërmbarrim dhe njofton Prokurorin e Shtetit.
7. Në këtë kontekst, Gjykata ka ndërmarrë masat e përcaktuara në Rregulloren e saj të punës përkitazi me Aktgjykimet: (i) në rastin KO01/09, të 18 marsit 2010, me parashtrues *Qemail Kurtishi* (në tekstin e mëtejme: rasti i Gjykatës KO01/09), duke lëshuar Urdhrin e 7 qershorit 2010 dhe Urdhrin e 21 qershorit 2010¹; (ii) në rastin KIO8/09, të 17 dhjetorit 2010, me parashtrues *Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Fabrikës së Çelikut, IMK*, në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: rasti i Gjykatës KIO8/09), duke nxjerrë Vendim për Mospërmbarrim dhe e kishte njoftuar Prokurorin e Shtetit²; (iii) në rastin KI112/12, të 5 korrikut 2013, me parashtrues *Adem Meta* (në tekstin e mëtejme: rasti i Gjykatës KI112/12), duke iu drejtuar me shkresë Kryetares së Gjykatës Themelore në Mitrovicë dhe duke e njoftuar Prokurorin e Shtetit për moszbatimin e këtij Aktgjykimi³; dhe (iv) në rastin KI187/13, të 1 prillit 2014, me parashtruese *N. Jovanović* (në tekstin e mëtejme: rasti i Gjykatës KI187/13), duke nxjerrë “Informatë të Përditësuar” përkitazi me Aktgjykimin KI187/13 si dhe duke e njoftuar Prokurorin e Shtetit për moszbatimin e Aktgjykimit KI187/13.⁴

Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI132/15:

8. Në rastin e Gjykatës KI132/15, kërkesa ishte dorëzuar nga Manastiri i Deçanit, i cili përfaqësohej në procedurat para Gjykatës Kushtetuese nga Dragutin (Sava) Janjić, kryemurg i Manastirit të Deçanit.

¹ Shih Urdhrin në rastin KO01/09, të 7 qershorit 2010, i qasshëm përmes vegëzës në vijim: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/urdher_rasti_ko_01_09.pdf dhe Urdhrin në rastin KO01/09, të 21 qershorit 2010, i qasshëm përmes vegëzës në vijim: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/urdher_rasti_ko_01_09.pdf

² Shih Vendimin për Mospërmbarrim të Aktgjykimit në rastin KIO8/09, të 14 nëntorit 2012, i qasshëm përmes vegëzës: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ki_08_09_vmsp_shq.pdf; dhe Njoftimin e Kryeprokurorit të Shtetit të për Mospërmbarrim të Aktgjykimit në rastin KIO8/09, të 28 majit 2019, i qasshëm përmes vegëzës: [KI08-09 Njoftim-për-moszbatim-të-Aktgjykimit-të-Gjykatës-Kushtetuese P.SH .pdf \(gjk-ks.org\)](https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/08/KI08-09_Njoftim-per-moszbatim-te-Aktgjykimit-te-Gjykatës-Kushtetuese_P.SH_.pdf).

³ Shih shkresën “Njoftimi përkitazi me moszbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI112/12” dhe shkresën drejtuar Kryetares së Gjykatës Themelore në Mitrovicë, të 17 prillit 2014, të qasshme përmes vegëzës në vijim: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/08/KI112-12_Njoftim-perkitazi-me-moszbatimin-e-Aktgjykimit_P.SH_SHQ.pdf

⁴ Shih “Informatë e Përditësuar përkitazi me Aktgjykimin nr.KI187-13”, të 6 shkurtit 2015, e qasshme përmes vegëzës në vijim: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/08/informate_e_perditesuar_KI187_13_shq.pdf dhe shkresën “Informim për moszbatimin e Aktgjykimit KI187/13”, të 6 shkurtit 2015 drejtuar Kryeprokurorit të Shtetit, e qasshme përmes vegëzës në vijim: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2021/08/njoftimi_per_moszbatimin_e_aktgjykimit_KI187_13_shq.pdf.

9. Parashtruesi i kërkesës kishte kontestuar dy vendime të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (ne tekstin e mëtejme: Kolegji i Ankesave të DHPGJS-së), përkatësisht Vendimet [AC-I-13-0008] dhe [AC-I-13-0009] të 12 qershorit 2015.
10. Parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy vendimeve të lartpërmendura, duke pretenduar shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me nenet 24 [Barazia Para Ligjit]; 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; 32 [E Drejta për Mjete Juridike]; 46 [Mbrojtja e Pronës]; 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ). Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte kërkuar vendosjen e masës së përkohshme deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës.
11. Më 12 nëntor 2015, Gjykata kishte miratuar masën e përkohshme deri më 29 shkurt 2016.⁵ Ndërsa, më 10 shkurt 2016, Gjykata kishte miratuar vazhdimin e masës së përkohshme deri më 31 maj 2016.⁶
12. Më 19 maj 2016, Gjykata vendosi që: (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë që ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; (iii) të konstatojë që dy Vendimet e 12 qershorit 2015 të Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, përkatësisht [nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009], janë të pavlefshme; dhe (iv) të konstatojë që dy Vendimet e Kolegjit të Specializuar për Pronësinë të DHPGJS-së të 27 dhjetorit 2012, përkatësisht [nr. SCC-08-0026 dhe nr. SCC-08-0227], janë përfundimtare, të detyrueshme dhe, si të tilla, janë *res judicata*.⁷
13. Dispozitivi i Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI132/15, ishte votuar si në vijim:

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, në mbështetje të neni 20 të Ligjit dhe në mbështetje të rregullit 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 19 maj 2016, me shumicë votash

VENDOS

- I. *TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;*
- II. *TË KONSTATOJË që ka pasur shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;*
- III. *TË KONSTATOJË që nuk është e nevojshme të ekzaminojë nëse ka pasur shkelje të neneve 24, 32, 46 dhe 54 të Kushtetutës, dhe të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;*
- IV. *TË KONSTATOJË që dy vendimet e Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për Çështje që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 12 qershorit 2015, nr.*

⁵ Shih Vendimin e parë të Gjykatës për miratim të masës së përkohshme në rastin KI132/15.

⁶ Shih Vendimin e dytë të Gjykatës për vazhdim të masës së përkohshme në rastin KI132/15.

⁷ Më gjerësisht lidhur me faktet e rastit, shih paragrafët 20-46 të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI132/15; lidhur me pretendimet, shih paragrafët 47-52; lidhur me pranueshmërinë e kërkesës, shih paragrafët 53-68; ndërsa, lidhur me arsyetimin dhe meritat e rastit, shih paragrafët 69-94.

AC-I-13-0008 dhe nr. AC-I-13-0009, janë të pavlefshme, dhe se dy vendimet e Kolegjit të Specializuar për Pronësinë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështje që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit të 27 dhjetorit 2012, nr. SCC-08-0026 dhe nr. SCC-08-0227, janë përfundimtare të detyrueshme dhe, si të tilla, janë res judicata;

V. TUA KUMTOJË këtë vendim palëve;

VI. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”

14. *Më 20 maj 2016, Gjykata kishte njoftuar palët përkatëse për nxjerrjen e Aktgjykimit të Gjykatës, si në vijim: (i) DHPGJS-në; (ii) Degën në Deçan të Gjykatës Themelore në Pejë; (iii) Komunën e Deçanit; (iv) NSH Bletaria “Apiko” (në tekstin e mëtejme: Apiko); dhe (v) NSH Ndërmarrjen Hoteliere Turistike “Iliria” (në tekstin e mëtejme: “Iliria”).*

Procedura në Gjykatë pas publikimit të Aktgjykimit:

15. *Siç u tha më lart, Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI132/15, është votuar më 19 maj 2016 dhe është publikuar më 20 maj 2016.*
16. *Dy (2) vite pas nxjerrjes së Aktgjykimit të Gjykatës, përkatësisht më 8 mars 2018, Manastiri i Deçanit dorëzoi një letër-kërkesë në Gjykatë lidhur me zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI132/15, duke theksuar se i njëjti nuk është zbatuar “për shkak të refuzimit të komunës së Deçanit që këtë vendim ta zbatojë”. Përmes shkresës në fjalë, Manastiri i Deçanit e njoftoi Gjykatën se: (i) më 23 prill 2017, kishte kërkuar zbatimin e Aktgjykimit në rastin KI132/15 nga Zyra Kadastrale e Komunës së Deçanit; (ii) më 26 maj 2017, Zyra e Kryetarit të Komunës së Deçanit, kishte refuzuar kërkesën e Manastirit të Deçanit; (iii) më 3 korrik 2017, kishte parashtruar ankesë në Agjencinë Kadastrale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: AKK); (iv) më 25 korrik 2017, AKK kishte kërkuar dokumentacion shtesë nga Manastiri i Deçanit; dhe (v) më 2 gusht 2017, Manastiri i Deçanit kishte dorëzuar dokumentet e kërkuara në AKK. Bazuar në shkresën e Manastirit të Deçanit, AKK nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim, dhe për pasojë, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga Gjykata që të veprojë bazuar në nenin 116 të Kushtetutës lidhur me zbatimin e Aktgjykimit të saj në rastin KI132/15.*
17. *Bazuar në shkresat e dorëzuara në Gjykatë, përgjigja e Zyrës së Komunës së Deçanit e 26 majit 2017, drejtuar Manastirit të Deçanit, ndër tjerash, thekson se (i) “me rastin marrjes së vendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Kuvendi Komunal i Deçanit ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme dhe ka marrë vendime në të cilat e kundërshton zbatimin e këtyre vendimeve dhe decidivisht është thënë se Drejtoria për Kadastër në Deçan dhe Agjencia Kosovare e Gjeodezisë të mos i zbatojë vendimet e lartpërmendura”; (ii) “menjëherë pas marrjes së vendimit të lartpërmendur gjyqësor të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, Ndërmarrjet Publike “Iliria” dhe “Apiko” me padi pranë Gjykatës Themelore në Pejë – Dega Deçan, kanë kërkuar anulimin e të gjitha kontratave për dhurim të tokave për Manastirin. Prej asaj kohe e deri në ditën e sotme Gjykata nuk i ka shqyrtuar këto padi”; (iii) “AKP [Agjencia Kosovare e*

Privatizimit] me padi ka kërkuar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës anulimin e të gjitha kontratave të lartpërmendura mbi dhuratat dhe gjithashtu prej atëherë e deri në ditën e sotme padia nuk është marrë në shqyrtim”; (iv) “në lidhje me këto ngastra kemi gjetur edhe Aktvendimin e Drejtorisë Komunale të Gjeodezisë në Deçan me numrin 07-952/624 të dt. 15.09.1992 me të cilin këto ngastra i kthehen në pronësi Komunës së Deçanit nga OP “Visoki Deçani”. Komuna e ka nisur zbatimin e këtij vendimi”; (v) “me ligj është paraparë se pronat e Ndërmarrjeve Publike për të cilat është nisur procedura e likuidimit nuk guxojnë ta ndryshojnë pronarin derisa nuk përfundon likuidimi. Kështu që për Ndërmarrjet Publike “Iliria” dhe “Apiko” ka filluar likuidimi më 22.02.2017”; dhe përfundimisht (vi) “duke marrë parasysh këto rrethana të lartpërmendura, ne si komunë nuk kemi mundësi të marrim çfarëdo vendimi”.

18. Më 8 nëntor 2018, Gjykata i ishte drejtuar DHPGJS-së lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës që Aktgjykimi i Gjykatës nuk është zbatuar dhe masat e ndërmarra nga DHPGJS-së për zbatimin e Aktgjykimit në rastin KI132/15. Përmes kësaj shkrese, Gjykata kishte kërkuar që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të njoftohet nëse Aktgjykimi përkatës ishte zbatuar në tërësinë e tij. Për më tepër, shkresa e Gjykatës gjithashtu kishte theksuar se (i) “nuk ka asnjë arsye në bazë të të cilës mund të arsyetohet mos-zbatueshmëria e një vendimi final dhe përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese”; (ii) “është përgjegjësi e organeve përgjegjëse që të gjejnë mënyrat dhe mjetet më të përshtatshme për të zbatuar një vendim të Gjykatës Kushtetuese në të cilin është gjetur se ka pasur shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”; (iii) “në mungesë të konfirmimit për zbatueshmërinë e plotë të Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI132/15, Gjykata Kushtetuese do të nxjerrë Vendim për Mospërmbarim, në përputhje me pikën (6) të rregullit 66 (Zbatimi i Vendimeve) të Rregullores së punës sipas të cilës parashihet që në rast të moszbatimit të një vendimi ose vonesës në dhënien e informacioneve, Gjykata Kushtetuese mund të lëshojë një aktvendim në të cilin do të theksohet që një vendim nuk është zbatuar. Më pas, në përputhje me pikën (7) të po të njëjtit rregull: Prokurori i Shtetit [do të] informohet për të gjitha vendimet e Gjykatës që nuk janë zbatuar”. Përfundimisht, Gjykata kishte theksuar se bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, vendimet e shpallura nga Gjykata Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës dhe se “mosekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese përbën shkelje kushtetuese dhe është në kundërshtim me parimet bazë të sundimit të ligjit në një shtet ligjor dhe demokratik”.
19. Më 28 janar 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës, përkatësisht, Manastirin e Deçanit, se: (i) Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI132/15 është shpallur nga Gjykata më 20 maj 2016; (ii) i njëjti është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës; (iii) më 20 maj 2016, lidhur me Aktgjykimin përkatës ishte njoftuar “Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Gjykata Themelore në Pejë-Dega Deçan, Komuna e Deçanit dhe ndërmarrjet “Apiko” dhe “Iliria””; (iv) bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, Aktgjykimi në rastin KI132/15 krijon detyrime për të gjitha palët e përfshira në proces; (v) Gjykata në vazhdimësi përcjell zbatimin e vendimeve të veta; dhe (vi) lidhur me Aktgjykimin në rastin KI132/15 dhe të gjitha vendimet e tjera të saj do të

“ndërmarrë të gjitha veprimet që ka në dispozicion në bazë të Kushtetutës, Ligjit dhe Rregullores së vet të punës”.

20. Më 21 nëntor 2019, DHPGJS-së dorëzoi në Gjykatë përgjigjen ndaj shkresës së Gjykatës për *“informatë përfundimtare lidhur me zbatimin e Aktgjykimit në rastin KI132/15”* të 8 nëntorit 2018. Përmes kësaj shkrese, DHPGJS-së, ndër tjerash, theksoi se: (i) *“Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, konsideron njësoj ashtu siç keni konstatuar edhe Ju në kërkesën tuaj se dy Aktgjykimet e Dhomës së Posaçme, SCC-08-0226 dhe SCC-08-0227 janë përfundimtare të detyrueshme dhe të përshtatshme për përmbarim”*; (ii) *“në bazë të nenit 116.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës”*; porse (iii) DHPGJS *“nuk ka asnjë autorizim ligjor të dhënë me Ligj që ka të bëjë me përmbarimin e Aktgjykimit përfundimtarë të gjykatave”*; dhe (iv) për më tepër, *“Gjykata Kushtetuese me Aktgjykimin KI132/15 nuk ka dhënë asnjë detyrë për Dhomën e Posaçme që duhet kryer në të ardhmen”*. Duke vënë theks në juridiksionin e përcaktuar me ligj dhe faktin se DHPGJS *“nuk ka autoritet ligjor dhe nuk mund të ndërmarrë asnjë veprim ligjor në zbatimin e këtij Aktgjykimi”*, DHPGJS megjithatë kishte theksuar se: (i) *“Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme informon se Aktgjykimet e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së të cilat janë shpallë si përfundimtare dhe të detyrueshme me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KI132/15 dhe në mungesë të kërkesës së palës, ende nuk janë pajisur me Klauzolën e plotfuqishmërisë, për të qenë të përshtatshme për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese”*; dhe (ii) *“deri më tani parashtruesi i kërkesës, Manastiri i Deçanit si palë në procedurë edhe pse ka interes ligjor e legjitim që të zbatohet Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, nuk ka parashtruar asnjë kërkesë në Dhomën e Posaçme, me të cilën kërkohet vendosja e klauzolës së plotfuqishmërisë në Aktgjykime e lëshuara, përfundimtare. DHPGJS-ja menjëherë do t'i pajisë këto Aktgjykime me klauzolën e plotfuqishmërisë”*. Në fund, DHPGJS-së, gjithashtu kishte theksuar se (i) *“nisur nga siç u tha më lartë, Dhoma e Posaçme është e mendimit që në pajtim me nenin 307.1 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, pala gjyq fituese ka autorizim ligjor të fillon që të ndërmarrë hapat e nevojshme ligjor me qëllim të përmbarimit të këtyre Aktgjykimeve përfundimtare, duke ju drejtuar me kërkesë Gjykatës përmbarimore, apo Zyrës Kadastrale në Komunën në të cilën gjendet prona lëndore e Aktgjykimit, për regjistrimin e saj në regjistrin kadastral në emër të saj”*; dhe (ii) *“për më tepër në bazë të nenit 13.1 nr.04/L-013 të Ligjit për Kadastër, vetë pala që ka interes të këtillë për zbatimin e Aktgjykimit, duhet ta parashtroj kërkesën tek organi kadastral për fillimin e procedurës për regjistrimin e të drejtës pronësore ne regjistrin kadastral.”*
21. Më 3 gusht 2021, Gjykata bazuar në rregullin 66 të Rregullores së Punës, rivlerësoi zbatueshmërinë e Aktgjykimeve të saj së bashku me shkresat përkatëse të pranuar dhe të dërguara nga Gjykata pas nxjerrjes së këtyre Aktgjykimeve, me qëllim të konstatimit nëse të njëjtat janë zbatuar. Bazuar në shkresat e dërguara nga Gjykata, rezultoi se nxjerrja e Aktvendimeve për Mospërmbarim është paralajmëruar në një numër rastesh, duke përfshirë rastin KI132/15, përmes shkresës së Gjykatës drejtuar DHPGJS të datës 21 nëntor 2019. Përkundër kësaj shkrese dhe në mënyrë që Gjykata të veprojë vetëm në bazë të informacionit të përditësuar, u vendos që shkresat përfundimtare duke

kërkuar informata shtesë t'u dërgohen palëve dhe autoriteteve përkatëse në një numër rastesh, duke përfshirë, rastin e Gjykatës KI132/15.

22. Më 11 gusht 2021, me qëllim të përditësimit të informacionit përkitazi me zbatimin e Aktgjykimit përkatës, Gjykata i dërgoi shkresë (i) parashtruesit të kërkesës; dhe (ii) AKK-së, duke marrë parasysh përmbajtjen e përgjigjes së DHPGJS-së dorëzuar në Gjykatë më 21 nëntor 2019 dhe faktin që, bazuar në shkresat e lëndës, ankesa e 3 korrikut 2017 e parashtruesit të kërkesës kundër vendimit të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Deçanit rezultonte të jetë në shqyrtim para saj.
23. Më 26 gusht 2021, AKK dorëzoi përgjigjen e saj në Gjykatë, duke theksuar, ndër tjerash, se (i) më 20 nëntor 2020, ka pranuar edhe ankesën [nr.03/3539/20] të parashtruar nga Manastiri i Deçanit; (ii) pas shqyrtimit të ankesës së lartcekur ka konstatuar se Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi në Komunën e Deçanit, nuk ka vepruar në pajtim me paragrafin 3.5 të nenit 3 (Regjistrimi i të drejtave të pronave të paluajtshme) të Ligjit nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, sepse *“ka bërë heshtje administrative në shqyrtimin e kërkesës së parashtruar nga përfaqësuesi i Manastirit të Deçanit”*; (iii) për pasojë, AKK ka lëshuar Aktvendimin [nr. 03/3539/20] të 17 dhjetorit 2020, përmes të cilit e ka detyruar Drejtorinë e Kadastrit në Komunën e Deçanit që të bëjë shqyrtimin e ankesës së Manastirit të Deçanit; (iv) më 15 janar 2021, i është drejtuar Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi në Komunën e Deçanit për kërkesë për informacion për veprimet e ndërmarra përkitazi me ankesën e lartcekur; (v) më 21 janar 2021, AKK është njoftuar nga Komuna përkatëse se ndaj Aktvendimit të lartcekur të 17 dhjetorit 2020 të AKK-së ka ushtruar padi në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë; (vi) më 18 shkurt 2021, Manastiri i Deçanit ka parashtruar ankesë në AKK për shkak të heshtjes administrative; (vii) më 22 mars 2021, AKK ka pranuar kërkesë nga Kryetari i Komunës së Deçanit, përmes së cilës është kërkuar që të mos procedohet kjo lëndë derisa të përfundojnë *“të gjitha negociatat që kanë filluar me Manastirin e Decanit, Qeverisë së Kosovës, Ambasadorët e Kuintit, OSBE dhe BE”* lidhur me çështjen në fjalë; (viii) pas shkresës së lartcekur të Kryetarit të Komunës, AKK nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim; dhe (ix) pas pranimit të shkresës së Gjykatës të 11 gushtit 2021, më 16 gusht 2021, AKK i është drejtuar Kryetarit të Komunës së Deçanit me kërkesë për informacion lidhur me zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës KI132/15 dhe nuk ka pranuar përgjigje.
24. Më 30 gusht 2021, Manastiri i Deçanit dorëzoi përgjigjen e tij në Gjykatë, duke sqaruar zhvillimet që kanë ndodhur që nga korrespondenca e fundit me Gjykatën Kushtetuese, duke bashkangjitur edhe shkresat relevante nga të cilat rezulton se: (i) më 26 gusht 2020, Manastiri i Deçanit, sërish kishte paraqitur kërkesë për regjistrimin e pronësisë sipas Aktgjykimit KI132/15 në Zyrën e Kadastrit të Komunës së Deçanit; (ii) pasi nuk kishte pranuar përgjigje në këtë kërkesë, më 12 tetor 2020, Manastiri i Deçanit kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim të vendimit në Zyrën e Kadastrit të Komunës së Deçanit; (iii) më 20 nëntor 2020, duke marrë parasysh që nuk kishte pranuar përgjigje nga zyra përkatëse në Komunën e Deçanit, Manastiri i Deçanit kishte parashtruar ankesë për shkak të heshtjes administrative në AKK; (iv) më 17 dhjetor 2020, AKK

përmes Aktvendimit [03/3539/20], kishte kërkuar nga Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi në Deçan që të vendos lidhur me kërkesën e Manastirit të Deçanit brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh; (v) Komuna e Deçanit nuk kishte nxjerrë vendimin sipas Aktvendimit të lartcekur të AKK-së, por më 21 janar 2021, kishte paraqitur padi kundër Aktvendimit të AKK-së në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të cilës Manastiri i Deçanit i është përgjigjur më 24 mars 2021; (vi) më 18 shkurt 2021, Manastiri i Deçanit, përsëri kishte paraqitur ankesë në AKK për shkak të heshtjes administrative nga ana e Komunës së Deçanit, duke theksuar, ndër tjerash, se bazuar në nenin 13 (Konflikti administrativ) të Ligjit nr.03/L-292 për Konfliktet Administrative, konflikti administrativ në këtë rast nuk është i lejuar, për më tepër që, bazuar në nenin 22 të të njëjtit ligj, padia nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit përkatës; dhe (vii) Manastiri i Deçanit nuk ka pranuar përgjigje nga AKK përkundër faktit që bazuar në nenin 116 të Kushtetutës, “*është obligim i të gjitha organeve dhe personave në Kosovë që të zbatojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese*”. Manastiri i Deçanit po ashtu thekson se (i) “*Kuvendi Komunal i Deçanit ka mbajtur seancë më 27.05.2019 në të cilën përsëri është paraqitur qëndrimi që Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese është i padrejtë dhe të cilin Komuna nuk do ta zbatojë, si dhe që zbatimi i Aktgjykimit do të krijonte pengesa të mëdha në mesin e qytetarëve të Komunës së Deçanit, për pasojat e së cilës Komuna nuk do të mund të përgjigjet*”; (ii) “*është e qartë që institucionet në të gjitha nivelet thjeshtë refuzojnë të zbatojnë këtë vendim, domethënë kryejnë pengesë të vetëdijshme dhe të qëllimshme të të drejtave tona*”; dhe (iii) “*luteni që të ndërmerreni gjithçka që keni në dispozicion, në mënyrë që e drejta jonë mbi tokën, përfundimisht të regjistrohet në emrin tonë, pesë vite pasi që Gjykata Kushtetuese ka nxjerrë Aktgjykimin numër KI132/15.*”

25. Më 3 shtator 2021, AKK dorëzoi në Gjykatë përgjigjen e Komunës së Deçanit lidhur me “*çështjen e Manastirit të Deçanit*” të datës 1 shtator 2021, përmes së cilës Kryetari i Komunës së Deçanit kishte theksuar, ndër tjerash, se (i) “*Komuna e Deçanit në vazhdimësi është shprehur dhe ka deklaruar mos pajtueshmërinë e saj me Aktgjykimin KI132/15 që ka të bëjë me pronat e Ndërmarrjeve Shoqërore APIKO dhe ILIRIA, të cilat me Aktgjykimin e lartë cekur [...] i janë dhënë (dhuruar) Manastirit të Deçanit*”; (ii) “*nga viti 2017, kemi tentuar që të kemi një mirëkuptim dhe një zgjidhje të harmonizuar me Manastirin e Deçanit për të përfunduar të gjitha kontestet me Manastirin e Deçanit*”; (iii) “*ju njoftojmë që Komuna e Deçanit nuk ka asnjë arsye e asnjë obligim dhe nuk merr përsipër zbatimin e këtij vendimi, përderisa të mos merr fund trajtimi përmes bisedimeve në mes Komunës dhe Manastirit ku do të zgjidheshin përfundimisht kontestet e krijuara mes nesh*”; dhe (iv) “*deri në një epilog përfundimtar kërkojmë nga AKK-ja që mos të merr asnjë veprim lidhur me këtë proces!*”

Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me zbatimin e Aktgjykimit në rastin KI132/15:

26. Siç është sqaruar më lart, përmes shkresës drejtuar DHPGJS-së të 8 nëntorit 2019, duke u bazuar në nenin 116 të Kushtetutës dhe rregullin 66 të Rregullores së punës, Gjykata kishte paralajmëruar nxjerrjen e Vendimit për Mospërmbarim dhe njoftimin e Prokurorit të Shtetit përkitazi me rastin e Gjykatës KI132/15, në “*mungesë të konfirmimit për zbatueshmërinë e plotë të Aktgjykimit të Gjykatës*

në rastin KI132/15”. Megjithatë, në gusht të vitit 2021, Gjykata edhe një herë i është drejtuar palëve përkatëse në mënyrë që të përditësohen informatat para Gjykatës përkitazi me zbatueshmërinë e Aktgjykimit të saj.

27. Më 22 shtator 2021, bazuar në vlerësimin e të gjitha shkresave para saj, siç janë paraqitur më lart, Gjykata njëzëri konstatoi se Aktgjykimi i saj në rastin KI132/15, nuk është zbatuar. Kjo sepse autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tij, as pas pesë (5) viteve të nxjerrës së këtij Aktgjykimi, nuk kanë ndërmarrë masat e nevojshme për zbatimin e tij, përkundër faktit që përmes Aktgjykimit të Gjykatës, dy Vendimet e Kolegjit të Specializuar për Pronësinë të 27 dhjetorit 2012 të DHPGJS-së [nr. SCC-08-0026] dhe [nr.SCC-08-0227], respektivisht, ishin deklaruar si përfundimtare, të detyrueshme dhe, si të tilla, *res judicata*.
28. Në konstatimin e lartcekur Gjykata ka ardhur duke u bazuar në shkresat e pasqyruara në këtë Aktvendim për Mospërmbarrim dhe përgjigjet e pranuar, përkatësisht: (i) theksimin e DHPGJS-së që ajo nuk ka kompetencë për të zbatuar këtë Aktgjykim të Gjykatës përkundër faktit që thekson se i njëjti detyrimisht duhet të zbatohet bazuar në nenin 116 të Kushtetutës; (ii) qëndrimin e Komunës së Deçanit, pas kërkesës së Manastirit të Deçanit të vitit 2017 për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës, se “*me rastin e marrjes së vendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Kuvendi Komunal i Deçanit ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme dhe ka marrë vendime në të cilat e kundërshton zbatimin e këtyre vendimeve dhe decidivisht është thënë se Drejtoria për Kadastër në Deçan dhe Agjencia Kosovare e Gjeodezisë të mos i zbatojë vendimet e lartpërmendura*”; (iii) qëndrimin e Komunës së Deçanit bazuar në shkresën e 1 shtatorit 2021 drejtuar AKK-së se e njëjta “*në vazhdimësi është shprehur dhe ka deklaruar mos pajtueshmërinë e sajë me Aktgjykimin KI132/15 dhe si pasojë nuk ka asnjë arsye e asnjë obligim dhe nuk merr përsipër zbatimin e këtij Aktgjykimi*”; dhe (iv) faktin se AKK, përkundër ankesave të vazhdueshme të Manastirit të Deçanit dhe përtej Aktvendimit [03/3539/20] të 17 dhjetorit 2020 përmes të cilit e kishte detyruar Zyrën Kadastrale Komunale që të marrë një vendim lidhur me këtë çështje dhe refuzimin e së njëjtës për të vepruar bazuar në Aktvendimin e AKK-së, nuk ka nxjerrë ndonjë vendim tjetër, duke u shtuar se për këtë kishte pranuar një shkresë nga Kryetari i Komunës së Deçanit, përmes së cilës është kërkuar që të mos procedohet kjo lëndë “*derisa të përfundojnë të gjitha negociatat që kanë filluar lidhur me pronat e kontestuara*”.
29. Gjykata vëren se pas nxjerrjes së Aktgjykimit të saj në vitin 2016, janë zhvilluar në sërë procedurash për më tepër se pesë (5) vite dhe të cilat kanë pasur vetëm efektin e moszbatimit të një Aktgjykimi përfundimtarë në kundërshtim me nenin 116 të Kushtetutës.
30. Gjykata në mënyrë të njëjtë ka vepruar edhe në raste të tjera dhe të cituara më lart, në të cilat ka vlerësuar se në kundërshtim më nenin 116 të Kushtetutës, vendimet e saj nuk janë zbatuar. Në shkresën drejtuar u.d. të Kryeprokurorit të Shtetit të 6 shkurtit 2015 përkitazi me rastin e Gjykatës KI187/13, Gjykata, ndër tjerash, kishte theksuar se përkundër faktit që qysh nga themelimi i Gjykatës “*pothuajse 99% të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese janë zbatuar*”, Gjykata “*duke qenë e përkushtuar që të ndjek procedurat e zbatimit të vendimeve të saj*”.

deri në realizimin e plotë të të drejtave të parashtruesve që dalin nga vendimet e saj”, identifikon rastet të cilat ende nuk kanë gjetur zbatim nga autoritetet përkatëse, duke u tërhequr vëmendjen *“institucioneve shtetërore që, në sajë të kompetencave dhe të detyrimeve kushtetuese që kanë, të sigurojnë mekanizma për ti zbatuar vendimet e saj, në përputhje të plotë me nenin 116.1 të Kushtetutës”*. Ndërsa, në shkresën e drejtuar Kryeprokurorit të Shtetit të 28 majit 2019 përkitazi me rastin e Gjykatës KIO8/09 dhe njoftimin përkatës për nxjerrjen e Vendimit për Mospërmbarrim, ndër tjerash, kishte theksuar se *“mosekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese përbën shkelje kushtetuese dhe është në kundërshtim me parimet bazë të sundimit të ligjit në një shtet ligjor dhe demokratik”*.

31. Gjykata gjithashtu thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), bazuar në të cilën, Gjykata sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës interpreton të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, një ndër aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili, ndër tjerash, kërkon që vendimet përfundimtare të gjykatave duhet të zbatohen dhe të mos vihen në pikëpyetje.⁸ Për më tepër, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, në mënyrë konsistente përcakton që e drejta për një proces të rregullt siç garantohet përmes nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe e cila është në mënyrë të drejtpërdrejtë e aplikueshme në rendin juridik të Republikës së Kosovës bazuar në nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës së saj, do të ishte *“iluzore”* nëse sistemet ligjore vendore do të *“lejonin një vendim gjyqësor përfundimtar të mbetëj i pazbatuar në dëm të një pale”* dhe do të ishte e *“paimagjinueshme që nenin 6 të përshkruaj në detaje garancitë procedurale të palëve – procedura të drejta, publike dhe të shpejta – pa i dhënë mbrojtje zbatimit të vendimeve gjyqësore”*.⁹ Situata të tilla do të ishin në kundërshtim të hapur me parimin e sundimit të ligjit të cilin shtetet kontraktuese e kanë marrë për detyrë ta respektojnë bazuar në KEDNJ-në.
32. Gjykata, për më tepër, rikujton që Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 3 [Barazia para Ligjit] të saj përcakton që Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Për më tepër, Kushtetuta në nenin 7 [Vlerat], gjithashtu përcakton që rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut. Sundimi i ligjit është po ashtu element që e reflekton trashëgiminë e përbashkët evropiane siç është përcaktuar në preambulën e KEDNJ-së dhe Kartën për të Drejtat

⁸ Shih, ndër tjerash, rastet e GJEDNJ-së, *Guðmundur Andri Ástráðsson v. Island*, kërkesa nr.23674/18, Aktgjykim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së i 1 dhjetorit 2020, paragrafi 238; *Brumărescu v. Rumania*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së i 28 tetorit 1999, paragrafi 61; si dhe *Agrokompleks v. Ukraine*, kërkesa nr. 23465/03, Aktgjykim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së i 25 korrik 2013, paragrafi 148.

⁹ Shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së *Romashov v. Ukraine*, kërkesa nr.67534/01, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 24 korrikut 2004, paragrafi 42.

Fondamentale të Bashkimit Evropian dhe është objektivë thelbësore e reflektuar në Statutin e Komisionit të Venecias.¹⁰

33. Marrë parasysh parimet e lartcekura, dhe pasi bazuar në shkresat e dorëzuara para saj, Gjykata ka konstatuar se Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI132/15 nuk është zbatuar nga autoritetet përgjegjëse të Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 116 të Kushtetutës dhe rregullin 66 të Rregullores së punës, Gjykata nxjerrë këtë Aktvendim për Mospërmbarrim përkitazi me rastin e Gjykatës KI132/15. Në të njëjtën kohë, Gjykata gjithashtu e njofton Prokurorin e Shtetit përkitazi me moszbatimin e Aktgjykimit të saj në rastin KI132/15.
34. Në fund, duhet të theksohet se përtej konstatimit të moszbatimit të një Aktgjykimi, përmes Aktvendimit për Mospërmbarrim dhe Njoftimit përkatës të Prokurorit të Shtetit, Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë për vlerësimin e përgjegjësisë për moszbatim të një vendimi të Gjykatës nga autoritetet përgjegjëse. Kompetenca për një vlerësim të tillë më pas i takon Prokurorit të Shtetit, bazuar në Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

¹⁰ Shih, ndër tjerash, (i) Preambulën e KEDNJ-së; (ii)Preambulën e Kartës për të Drejtat Fundamentale të Bashkimit Evropian; si dhe (iii) Statutin e Komisionit të Venecias.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 19 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe me rregullin 66 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 22 shtator 2021, njëzëri:

VENDOSI

- I. TË KONSTATOJË që Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KI132/15, me parashtrues *Manastiri i Deçanit*, i datës 19 maj 2016 **nuk është zbatuar** nga autoritetet përgjegjëse të Republikës së Kosovës;
- II. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim për Mospërmbarrim përkitazi me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastin KI132/15;
- III. T'UA KOMUNIKOJË palëve këtë Aktvendim për Mospërmbarrim;
- IV. TË NJOFTOJË Prokurorin e Shtetit për nxjerrjen e këtij Aktvendimi për Mospërmbarrim;
- V. Në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit dhe për qëllime të rregullit 66 (6) të Rregullores së punës, ky vendim do të publikohet në Gazetë Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në ueb-faqe zyrtare të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani

